



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 799 Më 08.03.2024
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

ANEKS KONTRATA

Numri i kontratës:¹ **623-24-1681-5-3-5/C561**

Numri i Brendshëm: **623-23-029-5-2-1/5**

KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

AGE group SH.P.K., UÇK-së p.n, Rahovec, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin Aneks Kontratë për punë e shënuara me poshtë:

Titulli i Aneks Kontratës: **RENOVIMI I OBJEKTIT TË VJETËR TË QKMF-së NË RAHOVEC - FAZA E DYTË**

Me numër identifikues: **623-24-1681-5-3-5**


- I.** Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për projektin: **RENOVIMI I OBJEKTIT TË VJETËR TË QKMF-së NË RAHOVEC - FAZA E DYTË**, me Numër të prokurimit: **623-23-2312-5-2-1/C484**, të datës: **13.06.2023**, e cila kontratë është në realizim e sipër.
- II.** Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga Menaxheri i Projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve për: **RENOVIMI I OBJEKTIT TË VJETËR TË QKMF-së NË RAHOVEC - FAZA E DYTË**, Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë sipas ofertës së datës: **05.03.2024**, me kushte të njëjta si në kontratën bazë.
- III.** Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit, ndërsa ekzekutimi i punëve dhe/ose shërbimeve duhen të përfundohen në afat jo më të gjatë se: **10 ditë pune** pas fillimit të ekzekutimit të Punëve dhe/ose Shërbimeve.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

- I. Kontrata bazë që është duke u përmbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
- II. Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: **9,730.00 Euro;**
(Nëntë mijë e shtatëqindetridhjetë Euro)
Sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit numër: **623-24-1681-5-3-5 & 623-23-029-5-2-1/5**
- III. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negocuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
- IV. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas perfundimit të punëve.
- V. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
- a. Marrëveshja e kontratës;
 - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
 - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.
- VI. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën: Shqipe² në tri origjinale, Dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Kontraktuesin:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Tahir Bala
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.03.2024	Data:	08.03.2024
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

III	Punët e ndryshme	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Total
Nr.	Pershkrimi i Pozicioneve	Paramasa dhe Parallogaria sipas Kontrates			
1	Furnizimi me material dhe montimi i solbankave në anën e jashtme (në fasadë) nga mermeri me gjersi deri ne 30,0 cm dhe trashesi 2,0cm . Llogaria në m'	m'	389.20	25.00	€ 9,730.00

€

9,730.00

